

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6700
E enjte, 8 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Fadil Kodra kthehet në krye të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË ME CHARLES KUPCHAN NGA KËSHILLI AMERIKAN PËR MARRËDHËNIE ME JASHTË | FAQE 4-5

KUPCHAN: SERBIA DO TA NJOHË KOSOVËN NË KËMBIM TË ANËTARËSIMIT NË BE



Charles Kupchan nga Këshilli Amerikan për Marrëdhënie me Jashtë ka shprehur bindjen se Serbia, në fund, do ta njohë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, në këmbim të

anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Por, mbetet të shihet se si dhe kur do të realizohet ky qëllim, ka thënë ai në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë"

AKTUALE



SHOIPËRIA AKUZON IRANIN PËR "AGRESION SHTETËROR", NDËRPRET MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE | F. 2

ERDOGANI SHPRESON NË MARRËVESHJE TË SHPEJTË NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË PËR TARGAT | F. 5

BAZËN E RE TË POLICISË SË KOSOVËS NË ZUBIN POTOK E VIZITOJNË KURTI DHE SVEÇLA | F. 7

EKONOMI



KEDS-I BËN THIRRJE PËR KURSIMIT E RRYMËS NGA INSTITUCIONET DHE KOMPANITË PUBLIKE DHE ATO PRIVATE | F. 8

KOSOVA DHE MALAJZIA DISKUTOJNË PËR BASHKËPUNIM NË MES TË BIZNESEVE TË TË DY VENDEVE | F. 8

SPORT



SONTE BALLKANI PËRBALLET ME CLUJIN | F. 10

PAHORI NË PRISHTINË: TË MBAHEN PREMTIMET, TË HIQEN VIZAT PËR KOSOVËN | FAQE 2



POLICIA ARRESTON 11 PERSONA, MERRESHIN ME TRAFIKIM TË ARMËVE DHE KULTIVIM TË DROGËS | FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pahor në Prishtinë: Të mbahen premtimet, të hiqen vizat për Kosovën

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Presidenti i Sllovenisë, Borut Pahor, ka qëndruar të mërkurën për vizitë në Kosovë. Ai ka kërkuar që Bashkimi Evropian t'i mbajë premtimet, duke hequr vizat për Kosovën.

Pahor, në konferencën për medie, gjatë vizitës në Prishtinë, tregoi për temat që ka biseduar me liderët e rajonit. "Siç thashë gjatë bisedës edhe me Vuçiqin, shtetet që kanë statusin e vendeve kandidate, t'u mundësohen sa më shpejt negociatat. Bosnjës t'i ofrohet statusi i kandidatës dhe në lidhje me liberalizimin e vizave për Kosovën të plotësohen premtimet", ka thënë ai.

Pahor, mes të tjerash, foli edhe për dialogun Kosovë - Serbi. "Duhet të bëjmë gjithçka që është në dorën tonë që t'i

anashkalojmë deklaratat dhe sjelljet që prishin shkallën e besimit dhe ulin mundësinë të gjejmë një zgjidhje konkludimi më konstruktiv. Nuk bëhet fjalë vetëm për problemin mes Beogradit dhe Prishtinës, por kemi të bëjmë edhe me probleme të tjera. Të them se në vitet e fundit si problem kryesor është përmendur ngecja në negociatat. Por unë jam i gëzuar për një rezultat të pjesshëm të dialogut në Bruksel", ka thënë Pahor.

Ai ka theksuar se marrëveshja për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe duhet të implementohet. "Edhe në Beograd kam thënë, edhe herën e kaluar këtu, unë e shoh si rrugëtim për përfundimin e besimit që të implementohen marrëveshjet e arritura, marrëveshja mes Prishtinës dhe Beogradit ishte, po



ashtu, për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Unë i kam thënë edhe Osmanit që të gjendet një zgjidhje që të arrihet kjo marrëveshje. Unë nuk

e di nëse ka alternativa, por derisa nuk ka propozime nga palët, vlen marrëveshja e arritur më parë", ka thënë Pahor. Ndërkaq presidentja e vendit,

Vjosa Osmani, ka kërkuar ndihmën e Pahorit për anëtarësimin e Kosovës në BE, NATO dhe për liberalizim e vizave.

Shqipëria akuzon Iranin për "agresion shtetëror", ndërpret marrëdhëniet diplomatike

TIRANË, 7 SHTATOR - Shqipëria ka ndërprerë marrëdhëniet diplomatike me Iranin, pasi ka thënë se ky vend qëndron pas sulmit kibernetik që ka ndodhur disa muaj më parë në Shqipëri. Stafit diplomatik të Ambasadës së Iranit në Shqipëri i është dhënë 24 orë kohë që të largohet nga Shqipëria. "Sulmi nuk ishte një operacion individësh, por një agresion shtetëror. Agresioni është orkestruar nga Irani", tha kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një konferencë për medie të mërkurën, duke shtuar se sulmi "është orkestruar dhe sponsorizuar nga Republika Islamike e Iranit".

Kjo është hera e parë që një shtet anëtar i NATO-s zyrtarisht fajëson Iranin për organizim të një sulmi kibernetik dhe që merr masa të tilla.

Sipas kryeministrit Rama, katër grupe iraniane janë organizuar për sulmin kibernetik në



Shqipëri, "ndër to edhe një ndër grupet më famëkeqe të terrorizmit kibernetik ndërkombëtar".

Rama tha se objektivi i këtij sulmi ishte shkatërrimi i infrastrukturës digjitale të Qeverisë së Shqipërisë, paralizimi i shërbimeve publike, si dhe grabitja e të dhënave dhe të komunikimeve elektronike nga sistemet qeveritare.

Shtëpia e Bardhë ka dënuar

veprimet e dyshuara të Iranit dhe ka paralajmëruar për "veprime të mëtejme" për sulmin "e pashembullt" kibernetik ndaj aleates së NATO-s. "Shtetet e Bashkuara do të marrin veprime të mëtejme për ta mbajtur Iranin përgjegjës për veprimet që kërcënojnë sigurinë e aleates së NATO-s dhe vendosin precedent shqetësues për hapësirën kibernetike", ka thënë zëdhënësj

e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Adrienne Watson, përmes një deklaratë.

Shqipëria, në muajin korrik, ka qenë cak i një sulmi të madh kibernetik, i cili paralizoi të gjitha faqet qeveritare, përfshirë platformën e shërbimeve online e-Albania, përmes së cilës qytetarët pajisen me shumicën e dokumenteve.

Pas këtij sulmi kibernetik, Ambasada Amerikane në Shqipëri ngriti alarmin për një kërcënim të mundshëm, që thuhej se kishte për cak një samit të organizuar nga opozita e Iranit në mërgim. Ky samit ishte planifikuar të mbahej në Durrës më 23 dhe 24 korrik.

Samiti ishte paraparë të organizohej nga Këshilli Kombëtar i Rezistencës së Iranit (NCRI) dhe Organizata e Muxhahedinëve të Popullit të Iranit (MEK), që të dyja grupe që avokojnë përmbyshjen e Qeverisë

së Iranit. Në Shqipëri, pranë qytetit të Durrësit, prej vitit 2016 strehohen rreth 3 000 anëtarë të organizatës MEK, pas kërkesës së parashtruar nga Shtetet e Bashkuara. Zyrtarët e Iranit i konsiderojnë terroristë anëtarët e këtij grupi.

Ende nuk ka pasur ndonjë përgjigje nga Irani për akuzat e bëra nga Shqipëria dhe për ndërprerjen e raporteve.

Një ekip i ekspertëve amerikanë për sulmet kibernetike nga Byroja Federale e Hetimeve (FBI) së fundmi shkoi në Malin e Zi, pas një sulmi masiv kibernetik ndaj qeverisë dhe shërbimeve të këtij shteti anëtar të NATO-s.

Një burim nga Agjencia Kombëtare e Sigurisë e Malit të Zi fillimisht kishte sugjeruar se shërbimet ruse të sigurisë dyshohej se qëndronin prapa sulmit, edhe pse një grup kuban më vonë mori përgjegjësinë për sulmin kibernetik.

BE-ja synon çmim tavan për gazin rus, Putini paralajmëron dimër të ftohtë

Bruksel, 7 shtator - Zyrtarët e Bashkimit Evropian kanë dhënë shenja se synojnë të vendosin çmim tavan për gazin rus pavarësisht prej kërcënimeve të Rusisë se mund t'i ndalë furnizimet në rast të një vendimi të tillë.

Rusia tashmë ka ndërprerë pjesërisht apo plotësisht furnizimet me gaz për 13 vende anëtare të BE-së, të cilat përdorin energjinë ruse për t'i ngrohur shtëpitë, për të prodhuar rymë dhe për t'i mbajtur në funksion fabrikat.

Shefja e Komisionit Evropian,

Ursula von der Leyen, u ka thënë gazetarëve më 7 shtator se "ne do të propozojmë çmim tavan në gazin rus" përveç masave të tjera. Ajo ka përmendur edhe shkurtimet e detyruara të energjisë elektrike përgjatë pikut të përdorimit. "Ne duhet t'i ndalim të ardhurat e Rusisë, të cilat i përdor (presidenti rus, Vladimir) Putin për ta financuar këtë luftë mizore në Ukrainë", ka thënë von der Leyen. Putini, në anën tjetër, ka paralajmëruar kundërpërgjigje. "Ne nuk do të ofrojmë asgjë nëse situata është në kundërshtim me interesat tona", ka thënë Putini në

një Forum Ekonomik në Vladivostok. "Ne nuk do të dërgojmë gaz, naftë, thëngjill, apo naftë për ngrohje. Ne nuk do të dërgojmë asgjë", ka thënë Putini. Para shpërthimit të luftës në Ukrainë, BE-ja ka siguruar 40 për qind të energjisë nga Rusia. Ministri çek i Industrisë, Jozef Sikela, u ka thënë senatorëve çekë më herët gjatë ditës se vënia e çmimit tavan në gazin rus nuk është zgjidhje për krizën aktuale. Sipas tij, ministrat e Energjisë së BE-së nuk duhet të diskutojnë diçka të tillë, në një takim që do ta zhvillojnë këtë javë.



Kurti takon Damir Marusic dhe Rachel Rizzo, hulumtues të lartë në Këshillin Atlantik

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, takoi të mërkurën hulumtuesit e lartë në Këshillin Atlantik (Atlantic Council), Damir Marusic dhe Rachel Rizzo. Përgjatë takimit diskutuan për situatën e përgjithshme politike në Kosovë dhe për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe për angazhimin e Republikës së Kosovës për një marrëveshje ligjërish të detyrueshme me njohje reciproke në qendër të saj.

Kryeministri Kurti dhe hulumtuesit e lartë, Marusic dhe Rizzo, shprehën këndvështrimet e tyre edhe mbi agresionin dhe invazionin rus në Ukrainë, për pasojat për kontinentin e Evropës dhe sigurinë e rajonit. Si një nga vendet e para që u është bashkëngjitur sanksioneve të BE-së, ShBA-së dhe Britanisë së Madhe kundër Federatës Ruse, kryeministri Kurti tha se Republika e Kosovës ka dëshmuar edhe një herë se është aleate e vlerave demokratike dhe



partnere e aleancës euroatlantike të cilës synon dhe duhet t'i bashkohet.

Me seli qendrore në Washington D.C., Këshilli Atlantik, i themeluar me 1961, është një

think-tank amerikan që mbulon fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Policia arreston 11 persona, merreshin me trafikim të armëve dhe kultivim të drogës

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Policia e Kosovës, në vazhden e përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit, ka realizuar një operacion policor në disa lokacione të ndryshme për veprat penale që ndërlidhen me trafikimin e armëve dhe kultivimin e bimëve narkotike. Më 7 shtator, Policia e Kosovës, përkatësisht Divizioni Kundër Krimin të Organizuar, në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit, kanë zhvilluar hetime intensive, me qëllim të zbardhjes së veprimtarive kriminale të disa personave të dyshuar që kryenin veprat e lartcekura. Si rezultat i veprimeve të marra është realizuar operacioni policor në rajonin e Mitrovicës së Jugut dhe në rajonin e Pejës, i cili ka rezultuar me shoqërimin në stacion policor të 11 personave të dyshuar. Po ashtu, njësitë policore në këto lokacione kanë kryer kontrolle të shtëpive dhe objekteve përcjellëse, pronë e të dyshuarve

të përfshirë në raste, me qëllim të mbledhjes së provave për veprimtarinë kriminale të të dyshuarve, me ç'rast është gjetur një plantacion i bimëve narkotike në fushë të hapur (pyll). Gjatë këtij operacioni policor në të dy rajonet në Pejë dhe në Mitrovicë të Jugut janë sekuestruar provat materiale si: shtatë armë (2 Ak47, 5 revole), rreth 70 fishekë kalibër të ndryshëm, 92 bimë kanabis (marijuanë) me lartësi 1- 1.5 m, mbi 25 gramë kokainë, 5 500 euro (para të gatshme), 6 telefona, si dhe dokumente relevante për rastin. "Pas procedurave të intervistimit, me urdhër të prokurorit kompetent, gjashtë prej tyre janë dërguar në mbajtje. Policia e Kosovës do ta vazhdojë përkushtimin për realizimin e detyrave për parandalimin dhe luftimin e krimit si dhe identifikimin dhe arrestimin e personave kryes të veprave penale", ka njoftuar Policia e Kosovës.



PSD-ja ia shtron tepihun e kuq ministrit Latifi: Hajde në QKUK, gjendja është e rëndë!

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Partia Socialdemokrate (PSD), e drejtuar nga Daradan Molliqaj, ka zhvilluar të mërkurën një aktivitet në oborrin e QKUK-së, ku ka kritikuar ministrin e Shëndetësisë, Rifat Latifi, për gjendjen në shëndetësi. "Hajde në QKUK, ministër! QKUK-ja është vendi ku secili qytetar e ka vërejtur a ka pasur ndonjë ndryshim nga qeveria e shpresës e 14 shkurtit. Të gjithë e dimë, në spitale asgjë s'ka ndërruar. Sepse ndryshimi nuk është propagandë as poezi. Ndryshimi përnjëmend është shëndetësi më cilësorë, shëndet më i mirë i qytetarëve. I kemi pasur dy figura kryesore të pushtetit në shëndetësi. Rifat Latifi dhe Arben Vitia. Njëri nuk po zbrit prej aeroplanit, tjetri drejtor në spital privat", është thënë në mesazhin e aktivistëve të PSD-së. Sipas tyre, gjendja në QKUK sot është veç më e rëndë: mungesë barnash thuajse menaxhimi i barnave është fizike kuantike, aparaturat s'punojnë ose u hyn uji, pacientët në lista të gjata të pritjeve. "Ministri i Shëndetësisë lobon për liberalizim të vizave. E dimë që shëndetësia ka shumë probleme. As nuk presim ato të adresohen menjëherë. Problemi është që puna as nuk ka nisur. Ministri nuk po shihet e angazhimi i tij s'po vërehet. Ne kemi sjellë këtë tepih të kuq për të. Ndoshta kështu do ta bindim që t'ia fillojë punën, mbase nxitet nga luksi e glamuri. Sepse deri më tani kemi parë një ministër i cili është totalisht jashtë realitetit", kanë theksuar aktivistët e PSD-së.





INTERVISTË ME CHARLES KUPCHAN NGA KËSHILLI AMERIKAN PËR MARRËDHËNIE ME JASHTË

Kupchan: Serbia do ta njohë Kosovën në këmbim të anëtarësimit në BE

Charles Kupchan, nga Këshilli Amerikan për Marrëdhënie me Jashtë, shpreh bindjen se Serbia, në fund, do ta njohë pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, në këmbim të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Por, mbetet të shihet se si dhe kur do të realizohet ky qëllim, thotë ai në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Marrë parasysh disponimin e publikut serb, i cili është kundër hyrjes së Serbisë në BE, nëse kusht për këtë është njohja e Kosovës, shtrohet pyetja se a mund të heqë dorë Serbia nga integritet evropian? "Mendoj se ka pak mundësi për këtë", përgjigjet Kupchan. Sipas tij, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka qenë "i aftë në balancim dhe ulje në dy karrige"

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Si e komentoni letrën e presidentit të Francës, Emmanuel Macron, dhe të kancelarit gjerman Olaf Scholz, dërguar udhëheqësve të Kosovës dhe të Serbisë, e cila thekson se normalizimi i plotë i marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit është thelbësor për Ballkanin Perëndimor?
Charles Kupchan: Letra e

Macronit dhe Scholzit vjen në kohën e duhur dhe bart mesazhin e duhur. Rritja e tensioneve midis Serbisë dhe Kosovës - dhe në të gjithë rajonin në përgjithësi - kërkon një angazhim më të madh, evropian dhe transatlantik. Edhe Macron, edhe Scholz kanë vërtet të drejtë kur thonë se ajo që nevojitet, është normalizimi i plotë i marrëdhënieve

ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ka kohë që Beogradi dhe Prishtina duhet të marrin vendime të vështira dhe t'i arrijnë kompromiset e nevojshme për këtë qëllim.

Nga 1 shtatori Kosova dhe Serbia kanë nisur ta zbatojnë marrëveshjen për lëvizje të lirë pa letra hyrëse/dalëse. Si e komentoni faktin që Prishtina

dhe Beogradi, pas disa muajsh e vitesh tensione, janë marrë vesh së paku për diçka?

Charles Kupchan: Kosova insiston në sovranitet të plotë. Qofshin në pyetje dokumentet personale apo targa, është e kuptueshme që Kosova dëshiron të funksionojë si një vend normal. Është pozitive arritja e marrëveshjes për dokumentet personale, së paku. Do të shohim nëse do të ketë marrëveshje për targa e makinave, në dy muajt e ardhshëm. Por, ka ca përparim, së paku në kuptimin më të ngushtë të fjalës. Në një kuptim më të gjerë, jemi dëshmitarë të ringjalljes së tensioneve ndërmjet grupeve të ndryshme në të gjithë rajonin - gjë që ndikon në situatën në Mal të Zi,

Bosnjë-Hercegovinë, pastaj në marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut... Pra, tensionet në rajon po rriten, në vend që të ulen.

Ka disa arsye për këtë. Njëra është pandemia, që ka çuar në rënie ekonomike. Është edhe lufta në Ukrainë, e cila ka shkaktuar polarizime politike në nivel global, përfshirë edhe Ballkanin, duke detyruar Serbinë dhe serbët e Bosnjës të marrin disa vendime të vështira. Prandaj, Moska po i shton ndoshta aktivitetet e saj, për ta manipuluar situatën në atë rajon. Gjithashtu, Ballkani tani ndihet disi i lënë pas dore nga ShBA-ja dhe BE-ja, sepse ato u kushtojnë shumë rëndësi ngjarjeve në botë, pas sulmeve

Erdogani shpreson në marrëveshje të shpejtë në mes të Kosovës dhe Serbisë për targa

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka shfaqur shpresën se Kosova dhe Serbia së shpejti do të arrijnë marrëveshje për targa e makinave. "Theksojmë se jemi të gatshëm ta ofrojmë gjithë mbështetjen tonë, sido që të mundemi. Ballkani nuk mund të tolerojë më këtë lloj problemi", ka thënë Erdogan të mërkurën në një takim me presidentin serb

Aleksandër Vuçiq në Beograd. Nga 1 shtatori Qeveria e Kosovës ka nisur zbatimin e vendimit të saj për riregjistrimin e makinave me targa që i lëshon Serbia në RKS - Republika e Kosovës. Procesi pritet të zgjasë dy muaj. Serbia kërkon negociata për këtë çështje, duke propozuar targa neutrale ndaj statusit të Kosovës, por Qeveria e Kosovës nuk pranon një gjë të tillë.

Vuçiqi ka thënë se në takimin me Erdoganin kanë diskutuar për bashkëpunim më të madh ushtarak. Ai ka përsëritur se Serbia dëshiron të blejë dronë turq "Bajraktarë". "Ne jemi të një linje dhe unë shpresoj se do të mund të arrijmë diçka të tillë vitin tjetër. Ne jemi të gatshëm të paguajmë më shumë para sesa ishim pajtuar në të kaluarën dhe të ofrojmë qindra miliona euro", ka

thënë Vuçiqi. Vuçiqi, po ashtu, i ka kërkuar presidentit turk që t'i ndihmojë në sigurimin e energjisë elektrike nga Azerbajxhani në Serbi. "I kam kërkuar të na ndihmojë në këtë çështje dhe të na sigurojë hapësirë për dërgimin e 100 megavatëve të energjisë nga Azerbajxhani në territorin tonë, sepse diçka e tillë do të na lehtësonte situatën në muajt e

dimrit", ka thënë presidenti serb. Presidenti turk Erdogan ka thënë të mërkurën se nuk i konsideron të drejta politikatat "provokative" të Perëndimit ndaj Rusisë. Ai i ka bërë këto deklarata pasi Bashkimi Evropian ka propozuar një kufi çmimi për gazin rus. Presidenti rus, Vladimir Putin, ka kërcënuar me ndaljen e të gjitha furnizimeve nëse BE-ja merr një hap të tillë.



të 11 shtatorit - në radhë të parë në Lindjen e Mesme, e tani ngjarjeve në Ukrainë. Pra, për shumë arsye jemi dëshmitarë të rritjes së tensioneve në Ballkanin Perëndimor dhe Kosova është vetëm një pjesë.

Kosova dhe shumica e vendeve perëndimore këmbëngulin që dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit të përfundojë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse, me njohje reciproke... Serbia e refuzon këtë dhe kërkon që Prishtina ta përmbushë dispozitën e Marrëveshjes së Brukselit për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk pranon. A ekziston rreziku i rritjes së tensioneve dhe, madje, i konflikteve të armatosura?

Charles Kupchan: Ekziston një model për tejkalimin e ngërçit në marrëdhëniet ndërmjet

Kosovës dhe Serbisë, por nuk është bërë shumë përparim në zbatimin e tij. Ka disa zhvillime, si ky me dokumentet personale, pastaj për çështjet ekonomike gjatë administratës [së ish-presidentit amerikan, Donald] Trump, por programi i normalizimit ekonomik nuk është zbatuar, ashtu siç nuk është formuar as Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Por, ka një plan dhe jam shumë i bindur se si do të përfundojë i gjithë procesi. Serbia do ta njohë përfundimisht pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës dhe një nga elementet kyçe të kësaj përpjekjeje do të jetë integrimi i saj në Bashkimin Evropian. Megjithatë, mbetet të shihet se si dhe kur do të arrihet ky synim.

Përmendni njohjen e Kosovës nga Serbia. E keni fjalën për njohjen formale, apo njohjen e heshtur, pra modelin e dy

Gjermanive?

Charles Kupchan: Unë besoj se njohja formale duhet të jetë parakusht. Kjo është leva që ka Bashkimi Evropian në marrëdhëniet me Serbinë: anëtarësimi i plotë në këmbim të njohjes së Kosovës.

Mirëpo, janë dy trendë negativë. Së pari, vetë lodhja e BE-së me zgjerimin. Në anën tjetër, derisa bëhet gjithnjë e më e qartë se Serbia do të duhet ta njohë Kosovën për të hyrë në BE, entuziazmi i qytetarëve të saj për integrimin evropian është në rënie. Hulumtimet tregojnë se më shumë se 50 për qind e tyre janë kundër anëtarësimit në BE. Prandaj, shtrohet pyetja nëse anëtarësimi në BE është një shtysë e mjaftueshme që lidhshipi serb ta njohë Kosovën...

Charles Kupchan: Besoj se, në fund, do të jetë një nxitje e fortë dhe e mjaftueshme për Serbinë

që t'i normalizojë marrëdhëniet me Kosovën. Aktualisht, këto procese janë në regres dhe lufta në Ukrainë është duke tërhequr vëmendjen më të madhe. Fluksi masiv i refugjatëve ukrainas mund ta ngadalësojë integrimin evropian. Megjithatë, e konsideroj si një pauzë të përkohshme. Duhet pasur parasysh se, përveç luftës në Ukrainë, bota po kalon edhe një pandemi me të gjitha pasojat e saj, përfshirë edhe ekonomike. Kjo mund të marrë pak kohë, por nuk do të bëhet një rregull i përhershëm i funksionimit.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka vite që po përpiqet të balancojë mes BE-së dhe Rusisë. Por tani, për shkak të luftës në Ukrainë, ai nuk mund të ulet më në dy karrige. Marrë parasysh disponimin e publikut, i cili është kundër hyrjes së Serbisë në BE nëse

kusht për këtë është njohja e Kosovës, a mund të ndodhë që, në fund, të heqë dorë nga integrimin evropian?

Charles Kupchan: Mendoj se ka pak mundësi për këtë. Vuçiqi është treguar i aftë në balancim dhe në uljen në dy karrige. Megjithatë, nuk besoj se Serbia do të donte të ishte për kohë të gjatë në një limbo strategjike, ose në aleancë me Kinën e Rusinë, kur pjesa tjetër e rajonit është e drejtuar kah integrimi euroatlantik. Edhe pse Serbia nuk i ka vënë sanksione Rusisë, lufta në Ukrainë ka treguar fytyrën e vërtetë të Moskës. Është një akt i pamatur agresioni ndaj fqinjit. Pushtimi i Ukrainës dhe shkatërrimi që ka shkaktuar, do ta dëmtojnë reputacionin e Rusisë dhe do ta dëmtojnë pozicionin e Rusisë në Ballkan - gjë që do ta përshejtojë kthesën e rajonit drejt Evropës dhe distancimin nga Moska.



ShSKUK-ja dhe FSShK-ja takohen për bashkëpunim

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Ushtruesja e detyrës e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), Pranvera Zejnullahu- Raçi, ka pritur në takim kryetaren e Federatës Sindikale të Shëndetësisë, Tevide Imeri.

Sipas njoftimit të ShSKUK-së, në takim është diskutuar për mbarëvajtjen e punës në kuadër të institucioneve shëndetësore që janë në varësi të ShSKUK-së.

Gjatë takimit u vlerësua puna e punëtorëve shëndetësorë, përderisa u tha se po punohet

për mirëqenie më të mirë të tyre.

Të dyja palët u pajtuan që në të gjitha grupet punuese në kuadër të ShSKUK-së me qëllim të informimit të drejtë dhe shtyrjes para të proceseve, të ketë edhe një përfaqësues nga FSShK.


“Manifesta 14” vazhdon të sjellë ngjarje të reja në qytet përgjatë muajit shtator

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Jemi në gjysmën e edicionit të “Manifesta 14” në Prishtinë dhe energjia e atmosfera e mirë në qytet po vazhdon. Përgjatë kësaj kohe “Manifesta 14” shënon në të gjitha hapësirat dhe eventet e saj mbi 70 000 vizita, si dhe kanë vazhduar mirënjohjet nga medie të ndryshme. Kjo ngjarje jo vetëm ka vënë në plan të parë skenën e artit dhe kulturës së Prishtinës por, ashtu siç shkruan dhe “Mousse Magazine”, “Manifesta 14” ndoshta është edhe më e suksesshme në rrënjësimin e qasjes kuratoriale

afatgjatë e të udhëzuar nga komuniteti”.

Shtatori është përplot evente, prej atyre me natyrë gastronomike në Qendrën për Praktikë Rrëfyese e deri te lojëra për fëmijë nëpër qytet. Ne mezi presim të shohim se çfarë do të sjellë e ardhmja në javët në vijim në Prishtinë.

Programi i “Manifesta 14” vazhdon të mbahet në të gjitha hapësirat me ekspozita, evente e ndërhyrje që janë të hapura prej të martës në të diel, duke nisur nga ora 10:00 deri në orën 20:00.



Fadil Kodra kthehet në krye të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Fadil Kodra është kthyer sërish në pozitën e drejtorit të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave pas pranimit të ankesës së tij nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Për këtë vendim ka njoftuar avokati i Kodrës, Faton Fetahu.

Fetahu në “Facebook” ka shkruar se “është anuluar vendimi kontestues i Ministrisë së Brendshme”. “Në cilësi të përfaqësuesit të autorizuar, më lejoni t’ju njoftoj që sapo e pranova vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të të cilit është aprovuar ankesa të cilën e kemi parashtruar dhe, si rezultat, është anuluar vendimi kontestues i



ministrin të Punëve të Brendshme dhe z. Kodra kthehet në pozitën e drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin Emergjent”, ka shkruar avokati Fetahu.

Ai ka shtuar se për detaje të tjera

ligjore do të njoftojë në orët në vijim.

Më 14 korrik ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, kishte marrë vendim për lirim nga detyra të Kodrës, i cili ishte u.d. i drejtorit të AME-së.

Në '98-n u strehuan rreth 100 mijë shqiptarë në Isniq, zbulohet memoriali përkujtimor

DEÇAN, 7 SHTATOR - Të mërkurën në Isniq të Deçanit është bërë zbulimi i memorialit përkujtimor, në kujtim të shpëtimit e strehimit të rreth 100 mijë shqiptarëve nga e gjithë Kosova në shtator të vitit 1998. Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se ky memorial do të

jetë dëshmi e zemërgjerësisë, bujarisë e fisnikërisë së shqiptarëve ndër breza. “Falënderoj Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale për financimin e këtij projekti dhe gjithë të pranishmëve që na nderuan me praninë e tyre sot!”, ka shkruar Ramosaj në “Facebook”.



70 të rinj të Gjilanit do të përfitojnë trajnime pa pagesë në fushën e IT-së

GJILAN, 7 SHTATOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Beetroot Academy Kosovo nëpërmjet të cilit 70 të rinj do të përfitojnë trajnime pa pagesë në fushën e IT-së.

“Ashtu siç jemi zotuar për përkrahje të veçantë të projekteve, programeve e aktiviteteve rinore, sot me Beetroot Academy Kosovo nënshkruam memorandum bashkëpunimi i cili ka për qëllim trajnimin e të rinjve të

komunës së Gjilanit në fushën e IT-së, fushë kjo me interes të përbashkët që krijon mundësi pune dhe rritje të njohurive”, ka thënë kryetari Hyseni, duke shtuar se përmes këtij bashkëpunimi, akademia

Beetroot do të trajnojë 70 të rinj të rajonit të Gjilanit pa pagesë përmes trajnimeve profesionale në fushën e teknologjisë, të cilat do t'i ndihmojnë të rinjtë tanë të krijojnë e zhvillojnë karrierën e tyre.



Bazën e re të Policisë së Kosovës në Zubin Potok e vizitojnë Kurti dhe Sveçla



MITROVICË, 7 SHTATOR - Policia e Kosovës tashmë është me bazë të re në Jasenovik të Zubin Potokut. Një ditë më parë këtë bazë e kanë vizituar kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla.

Pikërisht në shënimin e 23-vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës, Kurti kujtoi policin Enver Zymberi, i rënë në kryerje të detyrës zyrtare dhe në bartje të misionit për shtrirjen e plotë të sovranitetit dhe ligjshmërisë

në Republikën e Kosovës. “Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule në veri, në

vendin e rënies në detyrë të pjesëtarit të forcave speciale të Policisë së Kosovës, Enver Zymberi, në rrugën nacionale që lidh Mitrovicën me Zubin Potokun, në afërsi të fshatit Zubç”, thuhet në njoftimin për

medie.

Kurti dhe Sveçla, po ashtu, vizituan edhe bazën e re të Policisë së Kosovës në Jasenovik në Zubin Potok, si dhe kampin e Njësisë Speciale Belvedere në Mitrovicë.



Policia bën thirrje për kujdes në trafik

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Në kuadër të realizimit të detyrave ligjore dhe zbatimit të planeve operative “Sezoni veror” dhe “Siguria në trafikun rrugor” me qëllim të parandalimit të aksidenteve të trafikut, me theks të veçantë atyre me fatalitet, njësitë policor nga Stacioni Policor në Obiliq ka ndaluar një veturë. Pas matjes së nivelit të alkoolit me alkotestit, shoferi kishte 0.85 promil të alkoolit në gjak. Ndaj shoferit janë marrë masat ligjore. Atij i është shqiptuar gjoja prej 200 eurosh, dy pikë negative dhe i është konfiskuar patentshoferi për gjashtë muaj.

Policia e Kosovës do t'i vazhdojë këto aktivitete, me synim të parandalimit të aksidenteve në trafikun rrugor dhe u bën thirrje shoferëve që të bëjnë kujdes gjatë qarkullimit në rrugë. “Ftohen qytetarët e vendit që të bashkëpunojnë me policinë dhe për të gjitha kundërvajtjet që vërejnë në trafik, ta njoftojnë menjëherë policinë, stacionin më të afërt, apo përmes aplikacionit digjital ‘Lajmëro Policinë’ dhe në numrin pa pagesë 192. Të dhënat e juaja do të trajtohen me konfidencialitet të plotë”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Kurti i dërgon letër urimi kryeministres së Mbretërisë së Bashkuar, Liz Truss

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka dërguar letër urimi Liz Truss, me rastin e emërimit kryeministres së Mbretërisë së Bashkuar. “Kontinenti ynë përballet me sfida të shumta, që kërkojnë një përgjigje të koordinuar dhe unë ndihem i lehtësuar nga vizioni i qartë, që e theksuat në dy takimet tona në fillim të këtij viti. Ndërsa përballemi me pasojat e

pandemisë Covid-19, krizën e energjisë dhe koston e rritur të jetesës, së bashku me autoritarizmin në rritje dhe agresionin e paprovokuar të Rusisë kundër Ukrainës, ne presim me padurim udhëheqjen tuaj për ta ndihmuar Evropën dhe pjesën tjetër të botës të navigojnë nëpër këto kohë të vështira. Ju lutem, të jeni e sigurt se, teksa e bëni këtë, mund të mbështeteni në partneritetin,

bashkëpunimin dhe solidaritetin e Kosovës”, ka shkruar më tej kryeministri.

Ai ka shprehur mirënjohjen e Republikës së Kosovës për mbështetjen e Mbretërisë së Bashkuar në luftën tonë çlirimtare kundër një regjimi gjencidal. Në përmbyllje të letër urimit, kryeministri Kurti ka ftuar kryeministren Truss për vizitë në Kosovë, në mundësinë e parë të përshtatshme për të.



52 raste të reja me Covid

Prishtinë, 7 shtator - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët

e fundit, pas 492 testimeve, janë konfirmuar 51 raste të

reja me Covid-19. Janë shëruar 91 persona, ndërkaq raste aktive janë

536. Në 24 orët e fundit 28 qytetarë kanë marrë vaksinën kundër Covidit.



AKP-ja shpalli rezultatet e shitjes SHAL 58

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të mërkurën në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjes së asetëve në likuidim SHAL 58 përmes tenderit publik shpalli fituesit e përkohshëm për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion për shitje. Për 39 asete sa ishin në shitje gjithsej

u pranuan 82 oferta dhe vlera e tërësishtme e ofertave më të larta ishte 1 414 mijë e 754 euro. Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve janë bërë në mënyrë transparente, para përfaqësuesve të medie, përfaqësuesve të Odës

Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm. Ceremonia e hapjes së ofertave ka filluar në orën 12:30 dhe është mbajtur në sallën "Grand Hotel"-it në Prishtinë, ku edhe është bërë dorëzimi i ofertave nga ofertuesit nga ora 10:00 deri në orën 12:00.



KEDS-i bën thirrje për kursimin e rrymës nga institucionet dhe kompanitë publike e ato private

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 SHTATOR - "Aq sa është e rëndësishme të kemi furnizim me energji elektrike po aq jetik është edhe kursimi i energjisë elektrike. Për kursim sa më të madh të energjisë elektrike, ndihmesë të madhe paraqet bashkëpunimi me të gjitha institucionet publike, kompanitë private, bankat, hotelitë dhe të gjitha kategoritë e tjera", ka njoftuar KEDS-i në një komunikatë për medie.

Që kursimi i energjisë elektrike të jetë sa më lehtë i aplikueshëm dhe praktik, KEDS-i ka dhënë

disa rekomandime. "Meqenëse po u afrohem stinëve të ftohta, duhet pasur parasysh se ngrohja me energji elektrike përbën rreth 70 % të faturës mujore. Nga kjo kuptohet se shpenzuesi më i madh i energjisë është ngrohja. Andaj, nëse është e mundur, siguroni mundësi alternative të ngrohjes, sepse mosngrohja me energji elektrike do ta ndihmonte shumë sistemin. Temperatura e rehatshme e dhomës gjatë dimrit parashihet të jetë 18 deri më 21 gradë, andaj gjatë ditës ngrohja mund të ndalet për disa orë", është thënë në komunikatë.

Më tuje, është theksuar se kur

përdorimi i energjisë elektrike në ndërtesa publike është i panevojshëm pas përfundimit të punës, KEDS-i ka rekomanduar që të bëhet shkyçja e të gjitha objekteve, përveç aty ku cenohet siguria. "Në përfundim të orarit të punës, aty ku është e mundur, të ndërpritet energjia elektrike në mënyrë automatike apo të bëhet shkyçja përmes pajisjeve të mençura. Në kohë krize çdo kilovat i kursyer është i vlefshëm, andaj të fillojmë nga sot, t'i ndalim pajisjet që nuk i përdorim dhe të kursejmë në mënyrë maksimale", është theksuar në komunikatën e KEDS-it.



BE-ja shënon rritje ekonomike në tremujorin e dytë të 2022-s



BRUKSEL, 7 SHTATOR - Ekonomia e Bashkimit Evropian (BE) në tremujorin e dytë të këtij viti shënoi rritje prej 0.7 për qind krahasuar me tremujorin paraprak. Siç raporton Zyra evropiane e Statistikave (Eurostat), Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) në Eurozonë u rrit me 0.8 për qind krahasuar me tremujorin e parë. Në këto vende, PBB-ja u rrit me 4.1 për qind në tremujorin e dytë të 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Ndërsa, PBB-ja në BE u rrit me 0.7 për qind në tremujorin e dytë krahasuar me tremujorin paraardhës dhe me 4.2 për qind në krahasim me të njëjtën


periudhë të vitit të kaluar. Në BE pritej rritje prej 0.6 për qind krahasuar me tremujorin paraardhës dhe 4 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Eurozona shënoi rritje prej 0.6 për qind në krahasim me tremujorin paraardhës dhe me 3.9 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. PBB-ja në Spanjë dhe Itali u rrit me 1.1 për qind, në Francë me 0.5 për qind dhe në Gjermani me 0.1 për qind krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Punësimi në BE është rritur me 2.4 për qind krahasuar me të njëjtën tremujor të vitit të kaluar, kurse në Eurozonë punësimi është rritur me 0.4 për qind.

Kosova dhe Malajzia diskutojnë për bashkëpunim mes bizneseve të të dyja vendeve

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka pritur në takim ambasadorin e Malajzisë për Kosovën, Abdul Malik Melvin Castelino, me të cilin ka biseduar rreth mundësive të bashkëpunimit në mes të bizneseve të të dy vendeve.

Dy palët diskutuan rreth bashkëpunimit në mes odave të të dy vendeve për projekte të ndryshme si dhe angazhimin e përbashkët në afrimin e bizneseve të dy vendeve. "Kosova është vend i vogël, por me mundësi të mëdha për bashkëpunim me tërë botën", u shpreh në takim Rafuna.

Bashkëbiseduesit u morën vesh për shtimi të takimeve të përbashkëta, për harmonizim të projekteve mes dy odave si dhe bashkërendim të aktiviteteve, me qëllim që bizneset e dy vendeve tona të afrohen me njëra-tjetrën dhe të inkurajohet bashkëpunimi i dy ekonomive.



Si qytetërimi Minoan hodhi themelet e Evropës moderne



I konsideruar si qytetërimi i parë i përparuar në Evropë, ai Minoan ndikoi mbi historinë e gjithë Egjeut. Perandoritë e mëvonshme u frymëzuan nga planifikimi urban dhe kultura e këtij qytetërimi kretan. I lindur rreth vitit 3500 Para Erës Sonë, qytetërimi Minoan u përhap për mijëra vjet në Kretë dhe ishuj të tjerë të Egjeut.

Arkeologu i njohur britanik, Sir Artur Evans, ishte i pari që gjeti prova të një qytetërimi të Epokës së Bronzit në ishullin e Kretës në fillimin e shekullit XX. Duke gjetur mbetjet e një strukture të madhe urbane në anën veriore të ishullit, Evans përdori stratigrafinë dhe analizoi mostrat e qeramikës për të teorizuar ekzistencën e provave të një qytetërimi që i parapriu atij të Mikenasve.

Evans pretendonte se qyteti, që tregonte dëshmi të një strukture komplekse dhomash, të ndërlidhura të lidhura me një sërë korridoresh dhe shkallësh, dukej paksa si një labirinti i ngritur nga mbreti Minos. Duke u frymëzuar figura e famshme mitologjike greke, Evans e quajti vendin "Knossos" sipas emrit të pallatit të Minos.

Po ashtu ai propozonte që emri "Minoan" të adoptohej si një titull për qytetërimin e sapo-zbuluar. Kështu, termi përdoret gjerësisht si një emërtim për njerëzit, dhe vendbanimet që jetuan në Kretë dhe ishujt fqinjë gjatë viteve 3500-1100 Para Erës Sonë.

Evans zhvilloi një model bazuar në artefaktet qeramike që gjeti, duke e ndarë qytetërimin e zbuluar në tre periudha – Minoan i Hershëm, Minoan i Mesëm dhe Minoan i Vonë. Më vonë, arkeologu grek Nikolas Platon

shpiku një sistem të përcaktimit të dateve, bazuar në dëshmitë arkitekturore dhe kompleset e pallateve, duke i etiketuar ato si nën-periudha para, pro, neo dhe post-palaciale. Në të dyja sistemet, piketat e shënuara ndajnë çdo epokë minoane bazuar tek zhvillimi urban, arti dhe sistemet tregtare.

Dëshmitë arkeologjike flasin për një popullsi neolitike në ishullin e Kretës. Këta njerëz ka të ngjarë të kenë jetuar në fshatra të hapura, dhe të jenë marrë merreshin me bujqësi në fushën pjellore të Mesarës. Mbetjet e kasolleve të peshkatarëve janë zbuluar pranë brigjeve të ishullit, duke treguar gjithashtu se detaria dhe peshkimi ishin një mjet mbijetese për ta.

Epoka e Bronzit në Kretë nisi rreth vitit 3200 Para Erës Sonë, duke shënuar fillimin e periudhës së hershme Minoane. Dëshmitë mbi qendrat e vogla të tregtisë që lulëzuan gjatë kësaj kohe, tregojnë rrënjët e qendrave urbane dhe të strukturave komplekse në formën e pallateve, që do të karakterizonin epokat e mëvonshme Minoane.

Ndërtimi i pallatit si strukturë dhe i qytetit bashkë me të, nisi në të gjithë Kretën gjatë periudhës së Minoanit të Mesëm rreth vitit 2000 Para Erës Sonë. Këto pallate ishin qendra të qeverisjes dhe tregtisë, dhe në to strehohej gjithçka, nga punishtet e zejeve të ndryshme, magazinat ushqimore dhe teatrot.

Periudha e mesme Minoane, solli një zgjerim të tregtisë në të gjithë rajonin e Mesdheut. Dëshmi të mallrave të prodhuara nga qytetërimi Minoan janë gjetur deri në Egjipt, Anadoll dhe Kanan. Ajo ishte një periudhë

prosperiteti dhe stabiliteti, epoka e artë e Minoanëve.

Gjatë periudhës së mesme Minoane, filloi ndërtimi i qendrave komplekse të qyteteve në të gjithë Kretën dhe në ishujt fqinjë. Qyteti më i rëndësishëm Minoan ishte Knossos. Dëshmitë arkeologjike e datojnë qendrën e parë rezidenciale në vitin 2000 Para Erës Sonë.

Në kulmin e tij, popullsia e qytetit arriti në 100.000 banorë. Evans shpiku termin "ekonomi pallati" në shkrimet e tij mbi Minoanët, për të përshkruar sistemin paramonetar në qytete si Knossos. Të korrat dhe mallrat e tjera mblihdeshin nga qeveria, ruheshin në dhoma të mëdha brenda strukturës së pallatit, dhe shpërndaheshin më vonë tek popullata.

Një tërmet i ndodhur rreth vitit 1720 Para Erës Sonë, e shkatërroi pjesën më të madhe të pallatit Knossos dhe godinat rrotull. Gjatë 100 viteve të ardhshme, qendra e pallatit u rindërtua duke u bërë edhe më komplekse. Një sërë kolonadash dhe shkallësh që lidhnin ndërtesa të ndryshme, përbënin qendrën komplekse.

Uji sigurohej nga një sistem kullimi, kanalesh dhe tubacionesh shumë të sofistikura. I lidhur me qytetet e tjera të Kretës nga një sërë rrugësh të asfaltuara, Knossos shërbeu si një qendër tregtare për ishullin. Qendra të tjera të rëndësishme urbane të qytetërimin Minoan përfshinin Faistos, Malia dhe Akrotiri.

Akrotiri ndodhej në ishullin e sotëm të Santorinit, dhe në vendndodhjen e shpërthimit të vullkanit Thera, që më vonë do të shkaktohte edhe rënien e qytetërimin Minoan. Secili prej

tyre u ngrit në mënyrë të ngjashme me Knossos, me një strukturë komplekse ndërtimi që shërbente si qendër e qeverisjes dhe ekonomisë.

Një nga kontributet më të mëdha Minoane tek qytetërimet e mëvonshme të Egjeut, ishte një sistem i njëtrajtshëm i shkrimit. Dëshmia më e hershme e një sistemi shkrimi Minoan, është një shkrim hieroglifik që daton në vitin 2500 Para Erës Sonë. Një formë më e avancuar e shkrimit u zhvillua më pas, e quajtur nga Evans si Linear A.

Ajo ishte pararendëse e formës së njohur si Linear B, që u përdor nga Mikenasit, dhe që shërbeu si forma më e hershme e shkrimit e gjuhës greke. Këto gjuhë quhen lineare për shkak të praktikës së përdorimit të një majë shkruese për të prerë disa vija në pllaka prej balte për të prodhuar forma të shkruara të gjuhës.

Pllaka balte me mbishkrime lineare A, janë gjetur në mbi 40 zona të ndryshme në Kretë, duke treguar një sistem të përhapur të fjalës së shkruar Minoane. Arkeologët kanë zbuluar edhe prova të afreskeve, vulave dhe qeramikës së përpunuar, të cilat flasin për një kulturë artistike shumë të lulëzuar.

Afresket e gjetura nëpër hapësirat e pallatit janë si laike ashtu edhe fetare, me kafshë dhe njerëz. Qeramika Minoane është shumë interesante, pasi artefaktet nga periudha e mesme dhe e vonë, pasqyrojnë një model polikromi që i lejonte artistët të pikturonin dizajne të ndërlukuara. Stilet artistike të gjetura në qytetërimet e mëvonshme të Egjeut dhe Mesdheut, pasqyrojnë shumë nga të njëjtat stile të përdorura nga Minoanët.

Dëshmitë arkeologjike sugjerojnë se Minoanët jetonin në një shoqëri gjinore të ndara nga njëra-tjetra. Por arti dhe artefaktet tregojnë gjithashtu se ato mund të kenë qenë përafrimi më i mirë me një sistem matriarkati (sundim i grave) të zbuluar në rajon.

Arti fetar dhe artefaktet kanë në fokus gratë, që portretizohen si hyjni dhe burrat si shërbëtorë. Në shumicën e veprave artistike, gratë janë të veshura ndërsa burrat janë nudo. Dhe në shumë vepra, gratë shfaqen në një pozicion të ulur, të rrethuara nga burrat që qëndrojnë në këmbë.

Të gjitha këto tregojnë për statusin e rëndësishëm të gruas në kulturën Minoane. Është e vështirë të deshifrosh një shkak të vetëm që çoi në rënien e qytetërimin Minoan. Teoria më e njohur flet për një shpërthim masiv të vullkanit Thera rreth viteve 1550-1500 Para Erës Sonë.

Ky shpërthim shkatërroi jo vetëm zonat aty pranë, por reja e hirit dhe cunami që pasuan ndikuan shumë në Kretën Lindore. Edhe pse shpërthimi dhe pasojat e tij nuk sollën rënien e menjëhershme të Minoanëve, ai shkaktoi pasoja të mëdha ekonomike që e dobësuan të gjithë qytetërimin dhe i bënë ata të ndjeshëm ndaj pushtimit.

Gjatë rënies së ngadaltë, Minoanët u nënshtruan nga Mikenasit. Rezultati ishte një përzierje e dy kulturave, ku këta të fundit u frymëzuan nga shumë aspekte të qytetërimin Minoan. Ndikimi i Minoanëve në përparimet në zhvillimin urban dhe kulturor nuk mund të nënvlerësohet, pasi ata shërbyen si një bazament për perandoritë e ardhshme që do të sundonin zonat e Mesdheut dhe Egjeut.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Sonte Ballkani përballet me Clujin

Ballkani e pret sonte në "Fadil Vokrri" skuadrën e Clujit në kuadër të ndeshjes së parë në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës. Armend Thaqi ka premtuar angazhim maksimal për këtë ndeshje mjaft të rëndësishme për futbollin e Kosovës. "Të enjten e kemi ndeshjen debutuese në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës. Do të përgatitemi në maksimum për t'u paraqitur në mënyrë të denjë. Normalisht se do të jetë e vështirë, sepse dihen kualitetet e ekipit të Clujit", ka thënë Thaqi

EPOKA ERE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Skuadra kampione e Kosovës, Ballkani, e fillon një kapitull të ri sonte (e mërkurë), që është historik për futbollin Kosova, pasi për herë të parë një klub merr pjesë në grupet e Ligës së Konferencës. Ballkani i kaloi të gjitha pritshmëritë dhe arriti të kualifikohet deri në këtë fazë, duke bërë që Superliga e

Kosovës të shënojë rritje në renditjen e UEFA-s. Djelmohat që drejtohen nga Ilir Daja sonte në stadiumin "Fadil Vokrri" e presin skuadrën e madhe rumune, Cluj. Mbrojtësi i krahut të djathtë, Armend Thaqi, për "Epokën e re" ka folur për ndeshjen e radhës që skuadra kampione e Kosovës e zhvillon në grupet e Ligës së Konferencës. Ai premtonte maksimumin të enjten përbalë skuadrës së Clujit. "Jemi të



kënaqur me të arriturat historike që kemi bërë, por nuk jemi ndalur së punuari që sukseset t'i vazhdojmë. Të enjten e kemi ndeshjen debutuese në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës. Do të përgatitemi në maksimum për t'u paraqitur në mënyrë të

denjë. Normalisht se do të jetë e vështirë, sepse dihen kualitetet e ekipit të Clujit", ka thënë Thaqi. Skuadra e Ballkanit në këtë ndeshje vjen pas fitores që e arriti në fundjavë në derbin ndaj Prishtinës me rezultat minimal 0-1. Klubi nga Suhareka u ka bërë

thirrje të gjithë sportdashëve që të jenë të enjten në stadium për të përkrahur këtë klub, i cili me këtë rast po e përfaqëson gjithë Kosovën. "Eja në stadiumin 'Fadil Vokrri' të enjten dhe përjeto emocionet e një ndeshje evropiane. Ne nuk e përfaqësojmë vetëm Suharekën. Ballkani në këto ndeshje po përfaqëson Kosovën. Ballkani më shumë se asnjëherë ka nevojë për përkrahjen tuaj", thuhet në kërkesën e kampionëve në fuqi të Superligës.

UEFA ka caktuar gjyqtarët që do ta ndajnë drejtësinë në ndeshjen në mes të Ballkanit dhe Clujit. Në këtë ndeshje gjyqtarët nga Zvicra janë ata që do të ndajnë drejtësinë. Urs Schnyder do të jetë gjyqtari kryesor, kurse Marco Zurcher dhe Zurcher Benjamin do të jenë ndihmësit e tij. Sven Wolfensberger është caktuar për në rolin e gjyqtarit të katërt.

Ajazaj: Të gjitha skuadrat janë përforcuar, pritet një edicion mjaft atraktiv

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Edicioni i ri në basketbollin e Kosovës është në prag. Klubet e elitës janë në fazën e fundit të përgatitjeve dhe po bëhen gati për Superligë. Kapiteni i Ponte Prizrenit, Qëndrim Ajazaj, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve të skuadrës prizrenase. "Ekipi është i kompletuar dhe stërvitjet

po shkojnë shumë mirë. Faza përgatitore po shkon sipas planit të trajnerit (Arbnor Rifati)", është shprehur në fillim Ajazaj për faqen zyrtare të FBK-së. Në këtë edicion të gjitha skuadrat janë përforcuar dhe po pritet një garë shumë interesante në elitën e

basketbollit të meshkujve. "Jemi të vetëdijshëm që të gjitha skuadrat janë organizuar dhe përforcuar me lojtarë cilësorë. Qëllimi ynë është të kemi përfaqësim sa më dinjitoz dhe paraqitje të mira", ka shtuar kapiteni i prizrenasve. Ai ka folur edhe për synimet. "Sa iu përket synimeve, në radhë të

parë është mbijetesa, pastaj të shohim se si po ecin gjërat. Suksesi kurrë nuk është i garantuar, por jo dhe i papritur. Urojmë të kemi një edicion pa lëndime dhe ky edicion premtonte të jetë atraktiv dhe interesant për të gjithë basketbolldashësit", është shprehur Ajazaj.



Berisha: Melbourni është një sfidë e re, mezi pres ta filloj

MELBOURNE, 7 SHTATOR - Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Valon Berisha, i është bashkuar Melbourn Cityt në formë huazimi nga Reimsi. Ylli "dardan" ka thënë se është i emocionuar për këtë aventurë dhe që i bashkohet një skuadre kaq të suksesshme. "Jam shumë i

emocionuar që jam këtu në Melbourn me një skuadër që ka qenë kaq e suksesshme në fushë gjatë viteve të fundit dhe do të bëj më të mirën për ta ndihmuar skuadrën të fitojë më shumë fitime këtë sezon", ka deklaruar fillimisht Berisha. "Është një sfidë e re për mua dhe mezi pres të

filloj. Lojtarët dhe trajnerët kanë qenë fantastikë që kur erdha unë dhe jam i emocionuar t'i takoj tifozët e Cityt në ndeshjen tonë të parë", ka shtuar Berisha, i cili do ta veshë fanellën me numrin 14 dhe ai pritet të debutojë më 7 tetor ndaj Western Unitedit në "AAMI Park".

'Sigal Uniqa', sponsore gjeneral e Superligës së Femrave

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës ka nënshkruar edhe një marrëveshje të re bashkëpunimi tejet me rëndësi. Kompania e sigurimeve "Sigal Uniqua Group Austria", e cila tash e një kohë është partnere e FFK-së, do të jetë zyrtarisht sponsore gjenerale e Superligës së femrave në futbollin e Kosovës

dhe tash e tutje kjo ligë do të emërtohet Sigal Superliga e Femrave. Marrëveshjen e sponsorizimit e nënshkruan presidenti Agim Ademi dhe drejtori i përgjithshëm i kompanisë "Sigal Uniqua Group Austria", Avni Ponari. Futbollit i femrave është një nga prioritetet kryesore të këtij katërvjeçari të presidentit

Ademi, andaj do të punohet në vazhdimësi për krijimin e kushteve sa më të mira dhe përkrahja dhe përkushtimi nuk do të mungojnë. Edhe drejtori i Sigalit, Avni Ponari, u shpreh i lumtur për mundësinë e bashkëpunimit me FFK-në dhe për kontributin që kjo kompani do ta japë në zhvillimin e futbollit të femrave në vendin tonë.



Shkarkohet Tucheli, Chelsea ka në listë tre trajnerë

LONDËR, 7 SHTATOR - Skuadra e Chelsea e ka shkarkuar trajnerin Thomas Tuchel. Lajmi është bërë me dije nga vetë klubi londinez përmes një komunikate për medie. Chelsea nuk e ka nisur mirë sezonin në Premier Ligë, kurse ka pësuar humbje edhe në

ndeshjen e parë të Ligës së Kampionëve nga Dinamo Zagrebi. Tuchel ishte në krye të Chelseas prej vitit 2021, ndërsa arriti ta drejtonte skuadrën në një sukses të madh si triumfi në Ligën e Kampionëve në sezonin 2020-2021, ndërsa ia doli ta

siguronte edhe trofeun e Superkupës së Evropës dhe Botërorit për klube. Klubi i Chelseas ka falënderuar Tuchelin për kohën e shpenzuar në krye të skuadrës, ndërsa theksohet se stafi teknik do ta marrë përsipër drejtimin e ekipit deri në

emërimin e një trajneri tjetër. Ndërsa mediet angleze raportojnë se Graham Potter i Brightonit është favorit për ta marrë drejtimin e bluve, gjithashtu si opsion mbeten edhe Zinedine Zidane dhe Mauricio Pochettino.



Rugova: Do të angazhohem maksimalisht për t'i arritur synimet

PRIZREN, 7 SHTATOR - KB Bashkimi është skuadra më e vjetër në Kosovë. Prizrenasit gjithmonë kanë luftuar për trofe dhe kështu pritet edhe në këtë edicion. "Portokallezintë" kanë bërë disa përforsime me lojtarë të huaj dhe vendorë. Një ndër ta është Fisnik Rugova, i cili së fundi u aktivizua te Rahoveci, ndërsa ka fituar shumë trofe me Sigal Prishtinën dhe Pejën. "Kemi filluar përgatitjet me kohë dhe po japim më të mirën e mundshme. Kemi zhvilluar disa ndeshje miqësore deri më tani për ta parë formën e skuadrës para garave", ka thënë Rugova për faqen zyrtare të FBK-së.

Bashkimi në xhiron e parë do të përballlet me Vëllaznimin. Këto dy skuadra u sfiduan javën e kaluar në një miqësore. "Të gjitha



skuadrat janë bërë përforsuar në këtë edicion. Nuk ka asnjë ndeshje të lehtë. Ajo që u premtojmë tifozëve është se do të angazhohemi maksimalisht në

çdo ndeshje që do të zhvillojnë. Ky kampionat pritet të jetë interesant dhe sigurisht se synojmë paraqitje të mira dhe t'i realizojmë synimet tona", ka shtuar Rugova.

Mick tregon mesazhin emocionues që ka pranuar nga babai, Michael Schumacher

GENOLIER, 7 SHTATOR - Michael Schumacher kishte katër këshilla për djalin Mick përpara se i riu ta fillonte karrierën në Formula 1. Mick ndoqi hapat e babait legjendar, i cili fitoi shtatë kampionate në F1 gjatë karrierës së tij, duke iu bashkuar ekipit amerikan Haas vitin e kaluar. Pas një sezoni debutues makthi, në të cilin ai nuk arriti të fitonte asnjë pikë për ekipin e tij, 23-vjeçari ka treguar shenja përmirësimi të qartë këtë sezon, duke shënuar për herë të parë me një përfundim në vendin e tetë në Silverstone dhe, gjithashtu, duke ardhur i gjashti në GP të Austrisë.

Duke qenë djali i një shoferi që shumë e konsiderojnë si më të madhin e të gjitha kohërave, Schumacheri është futur në sport me më shumë presion mbi supet e tij se shumica, që do të thotë se krahasimet me babanë e tij ishin gjithmonë të pashmangshme. Por, vetë ikona e F1, i cili nuk është parë publikisht që kur ra në koma të shkakuar nga mjekësia pas një aksidenti në ski në vitin 2013, kurrë nuk u përpoq ta pengonte Mickun ta ndiqte pasionin e tij. "Babai im



ishte gjithmonë shumë mbështetës për gjithçka që bëja në karting", ka deklaruar ylli i Haas në një intervistë për "Mundo Deportivo". "Sigurisht. Mendoj se ai u përpoq të më jepte qasje të ndryshme për të parë se çfarë ishte më e mira për mua dhe në fund më thoshte gjithmonë: 'bëj atë që do'. Dhe për mua, ajo që kam dashur më shumë ka qenë gjithmonë gara. Më ka pëlqyer gjithmonë ajo që kam bërë dhe sa herë kam shkuar në ngjarje të mëdha, gara më të mëdha, ishte shumë mirë që ai e merrte kohën

me mua në autohome, duke diskutuar garat. Ishin kohë të mira", ka shtuar Mick Schumacher, i cili aktualisht e gjen veten në vendin e 15 në renditjen e pilotëve në F1 këtë sezon, 10 pikë prapa shokut të skuadrës së Haasit, Kevin Magnussen, në vendin e 11-të. Ai ka fituar 12 pikë deri më tani, duke u rikuperuar nga një ngjarje katastrofike kualifikuese në Arabinë Saudite herët në të cilën ai pësoi një përplasje tmerruese me shpejtësi të lartë për ta vendosur grupin e tij të parë të pikëve në tabelë.

SHKURT

Leipzig shkarkon trajnerin Tedesco

Leipzig ka vendosur ta mbyllë kontratën me trajnerin Domenico Tedesco. Disfata e fundit në Ligën e Kampionëve përballë Shakhtar Donetskut në shtëpi me rezultatin 1-4 ka sjellë edhe fundin e epokës së tij në drejtimin e klubit gjerman e cila zgjati vetëm 272 ditë. Gjithashtu, nga klubi janë larguar edhe dy ndihmëstrajnerët Andreas Hinkel dhe Max Urwantschky. Në sezonin e ri që ka nisur në Bundesligë, në pesë javët e para Leipzig ka grumbulluar vetëm pesë pikë, që kanë sjellë edhe vendimin drastik të klubit.

Ten Hag: Ronaldo mund të nisë në shumicën e ndeshjeve

Trajneri i Manchester Unitedit, Erik ten Hag, ka thënë se portugezi Cristiano Ronaldo është tani në gjendje të mirë fizike. Holandezi ka bërë me dije se pesë herë fituesi i "Topit të Artë" do të jetë i gatshëm të nisë në shumicën e ndeshjeve të Unitedit. "Ronaldo nisi ndaj Brentfordit, pastaj jo më, por ai është gati të nisë. Sigurisht se mund të nisë në shumicën e ndeshjeve", ka thënë Ten Hag. Cristiano Ronaldo nuk ka qenë pikë kyçe e Unitedit, së paku këtë fillim sezoni.

Neymari merr mbi 950 mijë euro për një reklamë në 'Instagram'

Besojeni ose jo, ylli i futbollit Neymar paguhet mbi 953 mijë euro për një postim në "Instagram". Hopper HQ ka zbuluar shifrat e disa prej fytyrave më të famshme në botë, që marrin nga ky rrjet social, shkruan "JustJared". Futbollisti që ka mbi 178 milionë ndjekës në "Instagram", kur publikon një fotografi ose video të sponsorizuar, merr shumë e lartpërmendur.

Mourinho: Roma ka peshë të madhe, gjithnjë nën presion

AS Roma është gati ta nisë aventurën evropiane, këtë herë në Ligën Evropiane, pas triumfit në Ligën e Konferencës. Në një intervistë për UEFA-n, Jose Mourinho ka folur për projektin e Romës. "Themelor ishte ndërtimi i një mentaliteti që nuk ishte i pranishëm te romanët prej shumë vitesh. Ky mentalitet u ndërtua paralelisht me një element tjetër që është vendimtar për mua: emocionalen. Për mua empatia shkon përtej grupit. Ai shtrihet edhe në atë se si klubi perceptohet nga pjesa tjetër e shoqërisë. Ky klub vlen shumë më tepër se ekipi, ka peshë të madhe, është nën presionin e komunitetit dhe tifozëve. Triumfi në Ligën e Konferencës ishte i rëndësishëm jo vetëm për ekipin, por edhe për klubin. Unë jam i vetmi që ia dola, asnjë lojtar apo trajner tjetër nuk e ka bërë", ka thënë Mourinho. "Vërtet më bën të qesh, po bëjmë shaka për këtë, por nëse e mendon është diçka që më bën të jem krenar. Megjithatë, ka ende një rrugë të gjatë për të bërë dhe unë do të përpiqem të arrij diçka më shumë", ka shtuar Mourinho.

Ancelotti: Lëndimi i Benzemas? Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar

Real Madridi fitoi 3-0 ndaj Celticut në ndeshjen e parë të fazës së grupeve të Ligës së Kampionëve. Një sfidë që

trembi jo pak tifozët, pasi sulmuesi kryesor i madri nënë, Karim Benzema, u zëvendësua në pjesën e parë.

Trajneri Carlo Ancelotti mendoi t'i qetësonte tifozët, teksa theksoi se nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, ndërsa

lojtari u nënshtrohet vizitave mjekësore për të mësuar edhe gjendjen e gjurit të tij. "Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, por do

të duhet të presim se çfarë do të thonë testet mjekësore", ka deklaruar tekniku i "Los Blancos".



Lokalno javno preduzeće
"Prishtina Parking" Sh.A. Priština

PRISHTINA
PARKING

Na osnovu člana 16,17 i 21 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 (SLUŽBENI LIST REPUBLIKE KOOSVA/PRIŠTINA: GODINA III/Br.31/15.JUNA 2008) i dopunu dotičnih izmena Zakona br. 04/L-III i br. 05/L-009, na osnovu statuta preduzeća br. 498 od 24.08.2022 sa drugim pozitivnim relevantnim normama, privremeni odbor direktora Lokalnog javnog preduzeća "Prishtina Parking" Sh.a., Priština, dana: 08.09.2022. godine objavljuje ovaj:

KONKURS

pozicija: Glavni izvršni direktor LJP "Prishtina Parking" Sh.a. Priština

Odgovara: Odboru direktora LJP "Prishtina Parking" Sh.a. Priština

Mandat: Glavni izvršni direktor se bira od strane Odbora direktora na period od 3 (tri) godinc.

Radno vreme: puno

Mesto: Priština

Naknada: Naknada glavnog izvršnog direktora će se obavljati u skladu sa članom 20. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i dopunu dotičnih izmena.

1. Generalno

Kandidat za ovu funkciju mora biti lice od integriteta, koje ispunjava kvalifikacione uslove i kriterijume samostalnosti, da poseduje potrebno stručno iskustvo i traženu stručnu spremu, kao i da ispunjava druge uslove propisane odredbama Zakona o javnim preduzećima i druga relevantna pozitivna akta.

2. Opis radnih zadataka i odgovornosti

- To je glavna figura i izvršni organ preduzeća;
- Odgovoran je za opšte upravljanje preduzećem, obezbeđujući njegovu dugoročnu administrativnu, finansijsku i funkcionalnu održivost;
- Vršiti planiranje, organizaciju, vodenje i kontrolu poslovanja preduzeća;
- Izrađuje i rukovodi sprovođenjem plana poslovanja preduzeća, plana budžeta i drugih strateških, kratkoročnih, srednjoročnih i dugoročnih planova preduzeća u skladu sa svojim strategijama;
- Obezbeđuje potpunu i blagovremenu izradu periodičnih, tromesečnih, godišnjih i drugih izveštaja preduzeća i vrši prezentaciju Odbora direktora i drugim organima po potrebi;
- Vršiti sistematizaciju i organizaciju radnika u skladu sa pozitivnim odredbama i razvojnom politikom preduzeća;
- Obezbeđuje uspostavljanje i funkcionisanje sistema interne kontrole, omogućavajući preduzeću da obavlja svoje aktivnosti na zakonit i etički način;
- Deluje kao veza između osoblja i Odbora direktora;
- Organizuje, nadgleda i odgovara za sve poslovne aktivnosti koje nisu u nadležnosti Opštinske komisije akcionara, Odbora direktora, Komisije za reviziju ili drugih organa;
- Obavlja i druge poslove utvrđene važećim zakonima, Statutom i internim aktima preduzeća, kao i drugim relevantnim pozitivnim aktima.

3. Uslovi stručne kvalifikacije i podobnosti

Kandidat koji ima za cilj poziciju glavnog izvršnog direktora u LJP "Prishtina Parking" Sh.a. Priština, mora ispuniti ove kriterijume:

- Da ima visoku stručnu spremu iz ekonomskih, pravnih, tehničkih oblasti ili iz drugih oblasti koje se odnose na delatnost u kojoj preduzeće posluje.
- Imati najmanje pet (5) godina iskustva - najmanje na visokom nivou menadžmenta - u oblasti poslovne administracije, finansija zadruge, finansija, upravljanja trezorom, banaka, konsultinga u poslovanju ili industriji ili iz druge oblasti nauke ili znanja vezano za poslovnu aktivnost JP ili (ii) najmanje pet (5) godina, da je bio javni računovođa, kvalifikovani pravnik ili kvalifikovani član druge profesije koja je usko povezana sa poslovnom delatnošću JP.
- Da poseduje organizacione sposobnosti, liderstvo i odlične komunikacijske sposobnosti.
- Da poseduje organizacione sposobnosti u radu sa računarom, za rad i radne zadatke.
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.
- Dokazi o znanju i drugim dostignućima će se uzeti u obzir i vrednovati u skladu sa relevantnošću za radno mesto.

- Da je lice visokog integriteta i da ispunjava sve uslove podobnosti predviđene članom 17. Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i dopune i dotične izmene Zakona o sprečavanju sukoba interesa u obavljanju javne funkcije br. 06/L-011, kao i sa relevantnim pozitivnim normama.

4. Potrebna dokumentacija

Kandidat za glavnog izvršnog direktora treba da dostavi sledeću dokumentaciju:

- Prijava (uzima se u kancelariji preduzeća ili na veb stranici preduzeća);
- CV-i;
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o stručnoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Uverenje da nije pod istragom (ne starije od šest meseci);
- Izjava pod zakletvom (uzima se u kancelariji preduzeća, ili na veb stranici preduzeća);
- Kopija lične karte.

5. Informacije o konkursnoj proceduri

Dokumentacija podnosioca zahteva se može preuzeti u kancelariji LJP, preuzeti sa zvaničnog sajta preduzeća i dostaviti u arhivu LJP „Prishtina Parking“ Sha.a, svakog radnog dana od 8:00 do 16:00 časova do 06.10.2022. , ili fizičkom poštom, (u zatvorenoj kovrti) na adresu: Za Odbor direktora LJP "Prishtina Parking" Sha.a. Priština - Prijava za glavnog izvršnog direktora.

Svi dokumenti moraju biti predstavljeni u kopijama, dok će njihovi originali biti potrebni u kasnijim fazama selekcije. Dodatne informacije se mogu dobiti putem e-mail adrese: info@prishtinaparking.net; ili direktno u arhivi preduzeće.

Obavještavamo vas da će imena, rezultati i kvalifikacije kandidata rangiranih kao „najpogodniji za izbor na ovom konkursu“ biti objavljeni na sajtu Monitoring projekta, a prijava svakog kandidata smatraće se davanjem saglasnosti za objavljivanje.

Konkurs je otvoren od 08.09.2022 do 07.10.2022. godine.

Beleška: Odbor direktora će razviti otvorenu/transparentnu proceduru u kojoj će se izbor vršiti isključivo na osnovu zasluga, u skladu sa važećim zakonom i bez ikakve diskriminacije, za šta podstiče prijavu kandidatkinja, kandidata iz sve zajednice Republike Kosova, kao i kandidate iz svih ostalih kategorija manje zastupljenih u institucijama/organima/organizacijama zemlje.



Qemaj Kallaba

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "KO-Procon" SH.P.K. me pronar Rustem Pllana, adresa: "Mbretëresha Teutë", Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810548480 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "KO-Procon" D.O.O. sa vlasnikom Rustem Pllana, adresu: "Mbretëresha Teutë", Mitrovicu, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810548480 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "KO-Procon" L.L.C. with owner Rustem Pllana, address: "Mbretëresha Teutë", Mitrovic, has come to the decision to quit its business: 810548480 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Ndërmarrja Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh. A. Prishtinë



Në bazë të nenit 16,17 dhe 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 (GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS /PRISHTINË : VITI III/ Nr.31/15 QERSHOR 2008), dhe plotësim ndryshimeve përkatëse me Ligjit nr.04/L-111 dhe nr.05/L-009, në bazë të Statutit të Ndërmarrjes nr.498 i datës 24.08.2022 me normat tjera pozitive relevante, Bordi i përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Prishtina Parking" Sh.a , Prishtinë , me datën : 08.09.2022, shpall këtë:

KONKURS

Pozita: Kryeshef Ekzekutiv të NPL "Prishtina Parking" Sh.a, Prishtinë

I përgjegjjet: Bordit të Drejtorëve të NPL "Prishtina Parking" Sh.a , Prishtinë

Mandati: Kryeshefi Ekzekutiv zgjedhet nga Bordi i Drejtorëve për mandatin prej 3 (tri) viteve.

Orari i punës: I plotë

Vendi: Prishtinë

Kompensimi: Kompensimi i Kryeshefit Ekzekutiv do të bëhet konform nenit 20 të Ligjit Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, dhe plotësim ndryshimet përkatëse.

1. Të përgjithshme

Kandidati/ja për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili/e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe aktet tjera pozitive relevante.

2. Përshkrimi i detyrave të punës dhe përgjegjësi

- Është figura kryesore dhe organi ekzekutiv i ndërmarrjes;
- Është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të ndërmarrjes duke siguruar qëndrueshmërinë afatgjate administrative, financiare dhe funksionale të saj;
- Bënë planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin e afarizmit të ndërmarrjes;
- Harton dhe udhëheqë implementimin e planit të biznesit të ndërmarrjes, planit të buxhetit dhe planeve tjera strategjike, afatshkurtesë, afatmesme dhe afatgjate të ndërmarrjes në akord me strategjitë e saj;
- Siguron hartimin e plotë dhe të kohshëm të raporteve periodike, tremujore, vjetore dhe raporteve tjera të ndërmarrjes dhe bënë prezantimin para Bordit të Drejtorëve, dhe organeve tjera sipas nevojës;
- Bënë sistemin dhe organizimin e punëtorëve konform dispozitave pozitive dhe politikave zhvillimore të ndërmarrjes;
- Siguron vendosjen dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm duke i mundësuar ndërmarrjes të ekzekutoj aktivitetet e saj në mënyrë të ligjshme dhe etikë;
- Vepron si ndërlidhje në mes të personelit dhe Bordit të Drejtorëve;
- Organizon, mbikqyrë dhe mban përgjegjësi për të gjitha punët e ndërmarrjes të cilat nuk janë në kompetencë të Komisionit Komunal të Aksionarëve, Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo organeve tjera.
- Kryen edhe punët tjera të përcaktuara me ligjet e zbatueshme, Statutin dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes si dhe aktet tjera pozitive relevante.

3. Kushtet e kualifikimit profesional dhe përshtatshmërisë

Kandadititi/ja i/e cili/a synon pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në NPL "Prishtina Parking" SH.A, Prishtinë, duhet t'i plotësoj këto kriteret:

- Të ketë diplomë universitare në fushat ekonomike, juridike, teknike apo në fusha të tjera të ndërlidhura me aktivitetet, në të cilat vepron ndërmarrja.
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë – së paku në një nivel të lartë menaxhmentit –në fushën e administrimit të biznesit, financave koporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së ose (ii) për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik , jurist i kualifikuar , ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së.
- Të ketë shkathtësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit.
- Të ketë shkathtësi të nevojshme në punën me kompjuter, për punën dhe detyrat e punës.
- Njohuria e gjuhës angleze është e preferuar.
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës.

- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësoj të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me nenin 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik nr /06L-011, si dhe me normat tjera pozitive relevante.

4. Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidatët për Kryeshef Ekzekutiv, duhet t'i dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- Aplikacioni(merret në zyrat e ndërmarrjes ose në web faqe të ndërmarrjes)
- CV-në;
- Letër motivim;
- Dëshmitë mbi kualifikimin profesional;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës;
- Çertifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Deklaratën nën betim (merret në zyrat e ndërmarrjes,ose në web faqe të ndërmarrjes);
- Kopja e letërnjoftimit

5. Informata për procedurën e konkurrimit

Dokumentacioni i aplikantëve mund të mirret në zyrën e NPL-së, shkarkohet nga web faqja zyrtare e ndërmarrjes dhe dorëzohet në arkivën e NPL "Prishtina Parking" Sh.a , çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00 deri 06.10.2022, ose nëpërmes postës fizike, (në zard të mbyllur) të adresuar: Për Bordin e Drejtorëve të NPL "Prishtina Parking" Sh.a, Prishtinë - Aplikacioni për kryeshef ekzekutiv.

Të gjitha dokumentet të paraqiten në kopje, ndërsa origjinali i tyre , do të kërkohe në fazat e më vonshme të përzgjedhjes. Informatat shtesë mund të sigurohen përmes e-mail adresës: info@prishtinaparking.net ; ose drejtpërdrejtë në arkivin e Ndërmarrjes.

Ju njoftojmë se , emrat, rezultatet dhe kualifikimet e kandidatëve të rankuar më lartë si "më të përshtatshëm për përzgjedhje në këtë konkurs", do të publikohen në web faqe të Projektit Monitorues, dhe se vet aplikimi i çdo kandidati do të konsiderohet edhe si dhënie e pëlqimit për publikim.

Konkursi është i hapur nga data 08.09.2022 deri me datë 07.10.2022

Shënim: Bordi i Drejtorëve do të zhvilloj një procedurë të hapur/transparente ku përzgjedhja do të bëhet ekskluzivisht në bazë të meritës, konform Ligjit në fuqi dhe pa asnjëllloj diskriminimi për çka inkurajon në aplikim kandidatet nga gjinia femërore.kandidatët nga të gjitha komunitetet e Republikës së Kosovës si dhe kandidatët nga të gjitha kategoritë tjera më pak të përfaqësuara në institucionet/organe/organizatat e vendit.

NPL "PRISHTINA PARKING" SH.A.

3

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ylner Skeraj shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Naim Frashëri " Vlashnje.

► Qendrim Kryeziu shpall të pavlefshme 4 dëftesat , certifikatën , diplomën shmt "11 Marsi " Prizren.

► Valdet Hasanaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Selman Riza", Gjakovë.

► Musë Gjoni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës: X,XI,XII si dhe diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

► Faton Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. Haxhi Hoti" Rogovë, nga klasa: -I- deri -VIII-.

► Qëndrim Rruka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

► Caner Mazrek shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi " Prizren

► Luan Grulaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

► Lendrit Raduni shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.

► Gzim Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

► Ardian Shabani shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit të Mjekësisë në UP, Prishtinë.

► Fares Zatriq shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë të shkollës së mesme "Mileniumi i Tretë" Prishtinë.

► Shkumbin Nuli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Mehmet Akif" Lipjan.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 676/1
 Dt: 07.09.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURSIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikë, 14 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndët profesionale të Mikrobiologji dhe Imunologji, 10 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndët Gjuhë Gjermane 18 orë mësimore;	Zëvendësim
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndët As. Siguria Ushqimore dhe Dieta 20 orë mësimore;	Zëvendësim

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silllet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
- Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lumë's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lumë's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

